



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLICA OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCII ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.:	Nr. Prot.:
Dep.:	Bi Prot.:
Nr. i faq.:	Data:
Drej. stranicë:	Datum:
Nr. përs.:	K. Nr.:
	PRISHTINE

DPK/OMP  
01  
03-105/14  
13.01.2014  
K. Nr. 4274/2012

**Gjykata Themelore në Mitrovicë - dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjeve në Skenderaj**, me gjyqtarin Gani Veseli dhe procesmbajtset Florie Gucati, duke vendosur në çështjen kundërvajtëse kundër të pandehurit, Sylë Salih Dervishaj, në fshatin Leqinë, Komuna e Skenderajt, për shkak të kundërvajtjes të shkaktuar nga neni 17.al.1.pika 3 të Ligjit Antikorrupcion, Nr. 043/L – 50 të Republikës së Kosovës, lidhur me neni 9 dhe 10 të LMK-ës, si dhe në kuptim të nenëve 30,31,37,74,195, të Ligjit mbi kundërvajtjet, me dt.20.12.2013, mori:

## A K T V E N D I M

**I pandehuri** : I. Sylë Dervishaj, i lindur më 29.09.1963, në fshatin Leqinë, i punësuar, i martuar, me profesion; Fakultetin e arkitekturës, kushtet ekonomike të mesme, shqiptar - shtetas Kosovar.

## Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

**Sepse** në muajin Mars të vitit 2012, zyrtari i Lartë Publik, nuk ka përmbushur obligimin Ligjor që parashihet me Ligjin 04/L-050, për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtërve të lartë publik. Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, ku nuk ju kanë papërbujtur nenit 9 të këtij Ligji.

Me këtë i pandehuri ka bërë kundërvajtje nga neni 17.al.1.pika 3, të Ligjit mbi deklarimin e pasurisë.

## D E N O H Ë T

**ME DËNIM Qortimi** për kundërvajtjen e shkaktuar nga neni 17.al.1.pika 1 të Ligjit Antikorrupcion të Republikës së Kosovës.

I pandehuri ngarkohet me paushall gjuqësor në shumë prej 10 Euro, në kuptim të nenit 109.al.1.pika 6 të LMK-ës, pagesa e kësaj shume bëhet në arkën e kësaj gjykate në afatin prej 15 ditësh pasi që vendimi të merr formën e prerë.

Nga një kopje e këtij Aktvendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit.

## A r s y e t i m i

Agjensioni Antikorrupcion, ushtroi kërkesën e vet, nr.01-2522/12 të dt.13.07.2012, me qëllim të hapjes dhe zhvillimit të procedurës kundërvajtëse, kundër të pandehurit të Lartëthekuar, për kundërvajtjen e shkaktuar nga neni 17.al.1.pika 3 të Ligjit Antikorrupcion.

Gjykata pas shqimit të kërkesës të ushtruar nga ana Agjencionit Antikorrupcion, konstatoi se kërkesa i plotëson kushtet për zhvillimin e procedurës. Gjykata mori Konkluzion mbi zhvillimin e procedurës kundërvajtëse me dt. 27.02.2013 dhe caktoi senacën e shqyrtimit për dt. 15.10.2013, ndërsa në pyetje u muar me dt.16.10.2013 dhe në mbrojtjen e tij i pandehuri shtoi: Është e vërtetë se unë nuk e kam ditur që formulari im për deklarimin e pasurisë nuk është dorëzuar në Agjencionin antikorrupcion. Na asambleistët në fundin e e asamblesë në muajin Mars i kemi plotësuar formularët dhe ua kemi lënë në sekretarinë gjegjësisht personave përgjegjës për administratë që të dorëzojnë formularët e mbushur. Mirpo pse si kanë dorëzuar këte nuk e kam ditur. Kur më është tërhequr vërejtja dhe kam marrë vesh se nuk ka shkuar formulari im atëherë unë e kam bërë menjëherë - e kam mbushur formularin. Gjendjen ekonomike e kam të dobët dhe nuk kam pasuri që vleë të theksohet se ka rëndësi. Prandaj unë këtë nuk e kam bërë për mshetjen e pasurisë apo diqka tjetër por vetëm që nuk e kam ditur.

Gjykata pas shqimit dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës si dhe nxjerrjes së provave në procedurë, erdhi në përfundim se i pandehuri Sylë nuk kishte përmbushur obligimin ligjor- deklarimin e pasurisë përmes aplikacionit ta Agjencionit Antikorrupcion për muajin Mars të vitit 2012. Këtë obligim e ka përmbushur pas afatit të paraparë me Ligj, në dt. Muajin e dhjetë të vitit 2012. Prandaj me këtë i njëjti ka bërë veprë kundërvajtëse – mospërmbushje të detyrimit në afatit ligjor për deklarimin e pasurisë. Për veprën kundërvajtëse të shkaktuar i njëjti mbanë përgjegjësi ligjore dhe Gjykata mu për këtë, të njëjtin e shpalli fajtor duke i shqiptuar një dënim qortimi në kuptim të neneve 17.al.1.pika 3, lidhur me nenin 9 dhe 10 të LMK-ës.

Gjykata ndaj të pandehurit aplikoi nenet 9 dhe 10 të LMK-ës për zbutje të jashtëzakonshme dhe dënim Qortimi, për shkak se i pandehuri veprën kundërvajtëse nuk e ka bërë me qëllim, por kjo ka qenë si pasojë që i njëjti nuk e ka ditur se aplikacioni i tij nuk është dorëzuar fare në Agjencionin Antikorrupcion. Gjyka mori përbazë arsyetimin – gjegjësisht mbrojtjen e të pandehurit se i njëjti me të vërtetë nuk e ka ditur se nuk i është dorëzuar aplikacioni i tij, si dhe mori përbazë gjendjen e tij të vështirë ekonomike.

Prandaj, Gjykata mendon se dënim i shqiptuar do ta arrijë qëllimin e vet dhe se është i mjaftueshëm për peshën e përgjegjësisë për veprën kundërvajtëse të kryer.

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese ndaj, të pandehurit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

## Gjykata Themelore në Mitrovicë- dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni i Kundërvajtjeve në Skenderaj.

Skenderaj, më dt.20.12.2013.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij Aktvendimi i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës kanë të drejtë ankese, në afatin prej 8 ditësh, pas marrjes së këtij Aktvendimi, Gjykatës së Apelit, Departamentit të përgjithshëm – Divizionit të kundërvajtjeve Në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate.

